



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika (6) dhe në pajtim me nenin 20 paragrafi (2) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM Për ndryshimin e Vendimit të Rezervës së Detyruar

1. Në Vendimin e Rezervës së Detyruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 177/21) në pikën 6) paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

"Norma e rezervave të detyruara të bankave është:

- 6,5% për detyrimet në valutë vendore;
- 50% për detyrimet në valutë vendore me klauzol valutore;
- 16,5% për detyrimet në valutë të huaj."

2. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe do të filloj të zbatohet prej 15 qershor të vitit 2022 me përmbushjen e rezervës së detyruar të llogaritur nga detyrimet e majit të vitit 2022.

**Nr. 02-12214/3
8 prill 2022
Shkup**

**Guvernatore
dhe kryetare
e këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска**